



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

NJOFTIM

PËR

**SHPALLJEN E SHPREHJES SË INTERESIT NGA ORGANIZATAT E
SHOQËRISË CIVILE / MBROJTËSIT E TË DREJTAVE TË NJERIUT,
PËR TË QENË PJESË E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË
KANDIDATËVE PËR KOMISIONER NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT
TË POPULLIT**

Të nderuar përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile/Mbrojtës të të drejtave të njeriut!

Në zbatim të nenit 33/1, pika 4 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit ka shpallur konkurimin për 2 (dy) vende vakant për Komisioner dhe konkretisht:

- ✓ Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve;
- ✓ Komisioner në Seksionin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Ç'njerëzor ose Poshtëruës;

Duke pasur parasysh që procesi i përzgjedhjes për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për Komisioner në institucionin e Avokatit të Popullit organizohet në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile apo mbrojtësit e të drejtave të njeriut, institucionit i Avokatit të Popullit:

I bën thirrje të gjithë individëve/ organizatave që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të cilat lidhen me fushën e veprimtarisë së Seksioneve përkatëse, të shprehin interesin e tyre për të qenë pjesë e këtij procesi përzgjedhjeje, brenda datës 03. 02. 2026, përmes konfirmimit në adresën elektronike: burime.njerezore@avokatipopullit.gov.al.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin e vazhdueshëm!